

Erald Shushari

Mban pozicionin e Drejtorit të Kabineti prej vitit 2019. Më herët ka punuar si "Avokat" pranë Dhomës së Avokatisë Berat dhe si Jurist në Sektorin e Marrëdhënieve me Gjqësorin në OSHEE sh.a. Ka kryer studimet e larta në fushën e Drejtësisë, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlore dhe ka përfunduar ciklin Master në fushën e së drejtës Administrative në Universitetin European të Tiranës (me burse të plote). Është autor dhe bashkautor i disa punimeve në fushën e së drejtës në revista shkencore të ndryshme.

Kabineti varet drejtpërdrejt nga Kryetari i Bashkisë; detyrat konkrete janë si më poshtë:

1. Përgatitja e materialeve dhe plotësimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së përditshme të Kryetarit, sipas axhendës së caktuar dhe miratuar paraprakisht prej tij.
2. Verifikimin e saktësisë, nga aspekti formal dhe ligjor, të materialeve të trajtuara nga strukturat përgjegjëse, përpara nënshkrimit të tyre nga Kryetari I Bashkisë.
3. Organizimin, përgatitjen, protokollimin e mbledhjeve dhe të takimeve që drejtohen nga Kryetari I Bashkisë, personalisht ose në emër të tij.
4. Koordinimin brenda atributëve të dhëna, të raporteve me institucionet shtetërore dhe entet e tjera publike dhe private;
5. Në varësi me axhendën e përcaktuar, përgatit materialet e kërkuara nga Kryetari dhe ndihmon Kryetarin dhe Nënkyetarin në plotësimin e funksioneve të tyre administrative.
6. Me miratim të Kryetarit, merr pjesë në analiza e takime të ndryshme që zhvillon Kryetari, si dhe mban kontakte me drejtoritë e Bashkisë, me qëllim zbatimin e detyrave të ngarkuara.
7. Bën përgjithësime e propozime për probleme që lidhen me politikat e zhvillimit të fushave që mbulon Bashkia.
8. I parashtron Kryetarit dhe Nënkyetarit mendime për çështje të ndryshme të rëndësishme të punës së përditshme.
9. Plotëson në kohë të gjitha detyrat që i ngarkohen nga Kryetari.
10. Mban dhe përgatit axhendën e Kryetarit të Bashkisë në takime me homologë brenda dhe jashtë vendit.
11. Përfaqëson Kryetarin e Bashkisë me porosi të tij në takime , aktivitete që organizon bashkia ose bazë të ftesave të dërguara bashkisë.